TATIMI MBI VLEREN E SHTUAR

NE

SHQIPERI

LIGJI 92/2014 DATE 24.07.2015

- TVSH- HISTORI
- FUSHA E ZBATIMIT
- PERSONI I TATUESHEM
- VEPRIMTARIA EKONOMIKE
- FURNIZMET E TATUESHME
- SHKALLET
- VLERA E TATUESHME
- PERJASHTIMET
- FURNIZIMET ME ZERO
- ZBRITJA E TVSH-SE
- SKEMA E MARZHIT

C’ESHTE TVSH

- **Tatim indirekt (barren e mban konsumatori/ e mbledh dhe e paguan tatimpaguesi)**
- **Tatim i përgjithshëm mbi konsumin e mallrave dhe shërbimeve;**
- **Proporcional me çmimin mallrave/ sherbimeve;**
- **I ngarkohet çmimit në çdo fazë të prodhimit dhe procesit të shpërndarjes;**
- **Tatim neutral, pasi paguhet tvsh qe rezulton pasi zbritet tvsh e paguar ne fazen paraardhese.**

ZINXHIRI I TVSH

	Prodhuesi	Tregtari me shumice	Tregtari me pakice	Konsumatori
Cmimi i shitjes neto	1.000	2000	4000	
Tvsh	200	400	800	
Cmimi i shitjes bruto	1200	2400	4800	4800
Cmimi i blerjes bruto	600 (import)	1200	2400	
Tvsh	100	200	400	
Cmimi i blerjes neto	500	1000	2000	
Tvsh paguar	100	200	400	
Tvsh e paguar ne import	100			
Tvsh e paguar ne buxhet	200	200	400	800

TVSH : taksë unike me pagesë të fraksionuar,

Ndërmjetësit ekonomikë	CMIMI blerje Pa TVSH	Marzhi	Cmimi shitjes	TVSH shitje	TVSH blerje	TVSH paguar
PRODHUESI A	**0**	**1000**	1000 + 200 = 1200	**200**	**0**	**200**
GROSISTI B	**1000**	1000 x 30% = **300**	1300 + 260 = 1560	**260**	**200**	**60**
PAKICA C	**1300**	1300 x 50% = **650**	1950 + 390 =2340	**390**	**260**	**130**
				TOTAL		**390**

Taksa : 20 %

KONSUMATORI
D

Paguar nga D:
1 950 + **390 TVSH** =
2 340 Lek

SHEMBULL – ZINXHIRI I TVSH-SE

- Faza 1
- Një minierë shet mineral hekuri në një fabrike në vlerë prej 1000 € dhe tvsh 20 %.
- Miniera i ngarkon klientët e saj 1200 €. Duhet të paguajë 200 euro për buxhetin, por pasi ka blerë mjete 240 € në të njëjtën periudhë kontabël, duke përfshirë edhe 40 € TVSH, paguan 160 euro (€ 200- 40 €).
- AT ka marre € 40 dhe tani merr € 160 duke e bërë € 200 - e cila është shuma e saktë e TVSH-së e duhur për shitjen e hekurit.
- • Furnizim: € 1000
- • TVSH për furnizim: € 200
- • TVSH për blerjet: € 40
- • TVSH neto që duhet paguar: € 160
- Faza 2
- Fabrika ka paguar 200 € TVSH në minierë dhe supozojme një tjetër TVSH prej 20 € për blerjet e tjera, siç janë mobiliet,kancelari, etj.
- Fabrika shet çelik prej € 2000, përfshirë 400 € TVSH kushton 2400 €. Zbret € 220 e paguar per blerjet dhe paguan 180 € në AT.
- AT merr këtë 180 € nga fabrika plus 160 € nga miniera, plus 40 € të paguara nga furnizuesi i mjeteve në minierë, plus 20 € të paguara nga furnitori mobiljeve.
- • Furnizim: € 2000
- • TVSH për furnizim: € 400
- • TVSH për blerjet: € 220
- • TVSH neto që duhet paguar: € 180
- € 180 (paguhet nga fabrika) + € 160 (paguhet nga miniera) + € 40 (paguhet nga furnizuesi në minierë) + € 20 (paguhet nga furnitori I fabrikes) = € 400 shuma e saktë e TVSH në një shitje me vlerë € 2000.

TVSH QE NGA 1995...

- **Prill 1995 miratohet ligji i TVSH 7928 ne fuqi nga Qershori 1996**
- **Qershor 1996** - aplikohet per here te pare.
  - Shkalla tatimore 12.5%;
  - Pragu i regjistrimit 2 milion lek /per cdo vit kalendarik.
- **Tetor 1997**, shkalla tatimore behet 20%.
- **Janar 1998** pragu i regjistrimit behet 5 milione leke.
- **Janar 2001**, pragu i regjistrimit behet 8 milione leke;
- **Ne 2008** aplikohet norma e kompensimit te fermereve 6%
- **Janar 2010** pragu i regjistrimit behet 5 milion leke;
- **Mars 2010** - Pragu i regjistrimit per profesionet behet 2 milion leke
- **Shkurt 2011**-Kufiri i regjistrimit per profesionet dhe hotelet behet zero.
- **Janar 2011- Prill 2014** Aplikohet shkalla e reduktuar e TVSH-se 10 % (barnat & sherbimet shendetesore);
- **Korrik 2014 miratohet ligji i ri 92/2014 ne fuqi nga 1 Janari 2015**
- **Nentor 2014** norma e kompensimit te fermereve behet nga 6% ne 20%
- **Qershor 2017 –** aplikohet shkalla e reduktuar 6 % per hotelet;
- **1 Prill 2018 –** kufiri i regjistrimit nga 5 million behet 2 million leke

FUSHA E ZBATIMIT

Një transaksion është në fushën e zbatimit të TVSH-së në Shqipëri nëse është:

- ***furnizim malli ose furnizim shërbimi,***
- ***i kryer kundrejt pagesës,***
- ***ne territorin e Republikes se Shqiperise,***
- ***nga nje person i tatueshem***
- ***qe vepron si i tille.***

Ne fushen e zbatimit te TVSH-se eshte:

- Importi i mallrave

FURNIZIM MALLI- FURNIZIM SHERBIMI

Ligji i përcakton transaksionet si:

- **<u>të tatueshme nga natyra</u>**
  - furnizimet e mallrave dhe sherbimeve qe ligji i percakton si furnizime te tatueshme, përveç kur bëjnë pjesë ne transaksionet e përjashtuara.

- **<u>të tatueshme nga ligji</u> (ligji i percakton si të tilla)**
  - edhe pse nuk janë transaksione të tatueshme për nga natyra, trajtohen si transaksione të tatueshme kundrejt pagesës, sepse nëse nuk tatohen ato shkaktojnë shtrembërim të konkurences.

- **Shembull:**
- Një person i tatueshëm, supermarket furnizon mallra ushqimore.
- Në fund të vitit u shpërndan dhuratë punonjësve të super-marketit nga një shportë mallrash me vlerë 7.000 lekë për festat e fundvitit.
- Ky person i tatueshëm kryen furnizime të tatueshme sipas natyrës pasi ai furnizon mallra ushqimorë të tatueshëm me TVSH.

- *Ndërkohë mallrat që shpërndan si dhuratë për punonjësit, edhe pse nuk janë shitur, për qëllime të TVSH ligji i konsideron si furnizim kundrejt pagesës dhe si të tilla konsiderohen transaksione të tatueshëm sepse ligji i përcakton të tillë.*


FUSHA E ZBATIMIT
SKEMA E ARESYETIMIT
Transaksioni eshte i tatueshem prej natyre ?
Po
Jo
Transaksioni eshte i tatueshem per shkak te ligjit ?
Transaksioni, gjendet ne fushen e zbatimit te TVSH.
Po
Jo
Transaksioni, eshte jashte fushes se zbatimit te TVSH ?
Transaksioni, eshte i perjashtuar?
A ka mundesi qe te zgjedhe opsionin per te zbatuar TVSH ?
Jo
Po
Po
Jo
TRANSAKSIONI ESHTE I TATUESHEM
JO I TATUESHEM
Person i tatueshem
Person i tatueshem opsional
Person i tatueshem i perjashtuar
Person i patatueshem

FURNIZIM MALLI/ FURNIZIM SHERBIMI

- **Furnizim malli ⇒ transferimi i së drejtës për të disponuar si pronar <u>pasurinë e trupëzuar.</u>**
- **Furnizim sherbimi ⇒ çdo transaksion që nuk është furnizim mallrash.**

Pasuri e trupëzuar = pasuri e luajtshme + pasuri e paluajtshme.

<u>Per rrjedhoje: furnizimi i pasurisë së patrupëzuar (emri i mirë, pronesi intelektuale IP, marka tregtare, etj) = furnizim sherbimi. (neni 10,11)</u>

Furnizimi i energjisë elektrike, ujit, gazit, energjisë për ngrohje ose ftohje dhe të tjera të ngjashme trajtohet <u>si furnizim malli i trupëzuar.</u>

FURNIZIME KUNDREJT PAGESES

- **Furnizimi i mallit ose furnizimi i shërbimit konsiderohet i kryer kundrejt pagesës, tërësisht ose pjesërisht, nëse furnizuesi direkt apo indirekt merr apo ka të drejtë të marrë, pagesë në para a në natyrë për atë furnizim, si prej personit të furnizuar apo ndonjë personi tjetër.**
- **Nuk eshte e rendesishme:**
  - Cili e kryen pagesen vete personi i furnizuar apo nje i trete;
  - Nese pagesa eshte ne para apo ne natyre;
  - Nese eshte marre pagesa apo do te merret

- **Kujdes ! Per TVSH-ne nuk ka rendesi emertimi i pageses si psh subvencion, sponsorizim, falje borxhesh etj).**
- Ne raste te tilla duhet te behet kujdes qe te verifikohet cdo pagese pavaresisht emertimit pasi mund te kemi te bejme me nje pagese ne kembim te nje furnizimi malli ose sherbimi te fshehur, I cili duhet te tatohet me TVSH.

FURNIZIME KUNDREJT PAGESES

- **Konsiderohen furnizime kundrejt pageses, nese eshte zbritur TVSH-ja ne blerje, rastet kur:**
  - a) personi i tatueshëm merr ose perdor mallra që janë pjesë e pasurisë së biznesit, për qëllim privat të tij apo të stafit të tij, apo për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike;
  - b) në rastet e çregjistrimit, të gjitha mallrat e furnizuara për personin e tatueshëm dhe ende në pronësi të personit të tatueshëm, si pjesë e pasurisë së biznesit;
  - c) një person i tatueshëm përdor për nevojat e biznesit të tij një mall të prodhuar, të nxjerrë, të përpunuar, të blerë, të importuar, në kuadrin e aktivitetit të tij, mall per te cilin kufizohet e drejta e zbritjes ose perdoret per aktivitet te perjashtuar;
  - ç) një person i tatueshëm përdor një mall në një sektor aktiviteti të përjashtuar, pa të drejtë zbritjeje te plote ose te pjesshme. E njejte edhe per furnizimin e sherbimit;
  - d) furnizimi i shërbimeve të kryera pa pagesë nga një person i tatueshëm për nevojat e tij personale apo të stafit të tij apo përgjithësisht për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike;

NUK TRAJTOHEN SI FURNIZIME KUNDREJT PAGESES

- **përdorimi i mallrave të biznesit si mostra (kampione);**
  - mostër (kampion) konsiderohen ato objekte nuk janë për qëllime shitje ose nuk shiten pasi kanë trajtën që pamundëson shitjen e tyre
  - Mallrat që jepen si mostra biznesi duhet të jenë të shenjëzuara si të tilla dhe duhet ta kenë trajtën ose paketimin ndryshe krahasuar me mallrat (objektet) të cilat kanë për qëllim shitjen.

- **dhuratat me vlerë të vogël;**
  - konsiderohet një mall me vlerë individuale të tregut më të vogël se 2.000 lekë, që shpërndahet pa pagesë për qëllim të zgjerimit, publicitetit dhe promovimit të veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm;
  - Në rastin kur dhuratat janë nga mallrat e biznesit ky rregull lejohet të zbatohet vetëm për një object, për të njëjtin përfitues dhe vetëm një herë në vit, pavarësisht vlerës së mallit, por jo më shumë se vlera e përcaktuar.

PERSONI I TATUESHEM

Person i tatueshem është çdo person qofte ky:

- Individ ose person fizik ose juridik, ose i organizuar ne çdo forme tjeter
- i cili ne menyre te pavarur kryen veprimtari ekonomike
- pavaresisht vendit, qellimit, ose rezultatit te kesaj veprimtarie.

Nuk ndikojnë në përcaktimin e të qenit person i tatueshëm:

- mungesa e fitimit;
- statuti i personave ose forma e organizimit;
- pergjegjesia perkundrejt llojeve te tjera te tatimeve;
- kryerja efektive ose jo e pagesës se TVSH-se.

Veprimtaria ekonomike

Veprimtari ekonomike është:

- **çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra ose shërbime, përfshirë veprimtarinë nxjerrëse, bujqësore dhe aktivitetet profesionale.**

- **shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar (te luajtshme ose te palujatshme) ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.**

Me pasuri të trupëzuar dhe pasuri të patrupëzuar kuptohen përkatësisht aktivet materiale (të luajtshme dhe të paluajtshme) dhe aktivet jo-materiale.

Vendi i furnizimit te mallit/sherbimit

Një nga kriteret që duhet marrë parasysh përsa i përket zbatimit të TVSH-së është:

- vendi i furnizimit te mallrave ose sherbimeve.

- **Sipas rregullave te ligjit:**
  - nese vendi I furnizimit te mallrave ose sherbimeve eshte ne Shqiperi atehere mallrat ose sherbimet tatohen me TVSH ne Shqiperi;

  - Nese vendi I furnizimit te mallrave/ sherbimeve nuk eshte ne shqiperi atehere keto furnizime nuk tatohen me TVSH ne Shqiperi;

REGJISTRIMI- CREGJISTRIMI

Detyrohen te regjistrohen per TVSH-ne:

- **Çdo person i tatueshem qarkullimi i te cilit kalon kufirin e regjistrimit, menjehere sapo kalon kufirin, pervec profesioneve qe e kane kufirin zero.**
  - Dorezon Inventarin dhe zbret tvsh-ne per inventarin vetem nese per ate inventar disponon fatura te blerjes me TVSH te pakten per 12 muajt e fundit;

- Fermeret e regjistruar me Nipt per qellime te skemes se fermereve detyrohen te regjistrohen sapo kalojne kufirin.

- **Çdo person i tatueshem qe kryhen <u>importe aktive qarkulluese</u> pavaresisht kufirit, jo AQT;**

- **Çdo person i tatueshem qe regjistrohet vullnetarisht pavaresisht kufirit;**

- **Çdo organizate jofitimprurese qe kryen veprimtari ekonomike, qofte edhe dytesore, nese kalon kufirin e regjistrimit prej te ardhurave nga veprimtaria ekonomike.**
  - Nëse nuk kryen veprimtari ekonomike nuk është e detyruar të regjistrohet.

- **Qarkullimi** **që shërben për zbatimin e regjimit, përfshin qarkullimin e realizuar nga të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, të kryera nga i njëjti person i tatueshëm, dhe llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që duhet të paguajë blerësi, pa përfshirë TVSH-në.**

- **Çdo person i cili plotëson kriteret për t'u regjistruar si person i tatueshëm për TVSH-në dhe nuk është regjistruar, e as ka kërkuar të regjistrohet për TVSH-në, regjistrohet në mënyrë të detyrueshme nga autoriteti tatimor në momentin (periudhën) qe konstatohet.**

- **Detyrimet për TVSH-në për furnizimet (shitjet) e kryera për periudhat e mëparshme që ka qenë i detyruar të regjistrohej, i llogariten me efekt nga data kur ka qenë i detyruar të regjistrohej.**

- **Këto detyrime do të vlerësohen në regjistrin e TVSH-së në emër të personit të tatueshëm në periudhën e parë që ai regjistrohet për TVSH-në.**
- **Subjektet qe konstatohen se kryejne evasion fiscal regjistrohen menjehere ne regjimin normal te TVSH-se**

• Çregjistrimi nga TVSH

- **Çdo person i tatueshëm i regjistruar në regjimin normal të TVSH ka të drejtë të kërkojë të çregjistrohet nga TVSH, në rastet e mëposhtme:**
  - a) Kur personi i tatueshëm mbyll veprimtarinë e tij ekonomike.
  - b) Kur personi i tatueshëm ka plotësuar kushtet dhe procedurën për t'iu nënshtruar regjimit të bizneseve të vogla.
    - **Per 12 muaj ka realizuar qarkullim me pak se kufiri, kerkon te c'regjistrohet nga TVSH dhe kerkesa e tij hyn ne fuqi pas 12 muajsh.**
  - c) Kur personi i tatueshëm i regjistruar vullnetarisht, heq dorë nga zgjedhja për të qenë i regjistruar për TVSH-në, por jo me pare se 2 vjet nga momenti i regjistrimit.

- **Kur ç’regjistrohet subjekti:**
  - Trajton si furnizim kundrejt pageses me TVSH mallrat stok (inventar) të pashitura, aktive të tjera të përdorura për veprimtarinë, ku TVSH-ja mbi këto mallra ka qenë tërësisht apo pjesërisht e zbritshme.
  - Per mallrat capital eshte I detyruar te beje rregullimin e kreditimit te TVSH-se nese eshte kredituar TVSH dhe jane perdorur me pak se 5 vjet.
- **Bazuar në nenin 38 të ligjit, vlera e tatueshme e këtij furnizimi duhet të jetë e përbërë nga:**
  - çmimi i blerjes së këtyre mallrave ose
  - në mungesë të çmimit të blerjes nga vlera e kostos e përcaktuar në momentin kur personi i tatueshëm përfundon veprimtarinë e tij ekonomike të tatueshme.

• Furnizimi kundrejt pageses

- **Shembull:** *Një prodhues apo shitës televizorësh ose makinerish transferon pa pagesë tek një klient, furnizues apo një punonjës i stafit të tij një televizor apo makineri të marrë nga stoku, atëherë* ***jemi në kushtet e një furnizimi kundrejt pagesës.***

- **Shembull:** *Një ndërtues ndërtesash i cili ka ndërtuar një ndërtesë pjesërisht për ta shitur dhe pjesërisht e jep me qira të tatueshëm.*
- *Ky ndërtues rezervon të drejtën e përdorimit të një ambienti apo një pjesë të ndërtesës për qëllime të ndryshme nga ato të shitjes (banim personal, strehim pa pagesë për stafin e tij).*
- *Megjithatë, theksohet se përsa* ***ai e përdor ambientin për realizimin e operacioneve të tatueshme (qiradhënie për shembull)****, përdorimi prej tij i ambienteve ose i stafit të tij për strehim, konsiderohet furnizim kundrejt pagesës dhe si i tillë tatohet me TVSH.*

***Shembull 1**: nje person i tatueshem qe tregton bojra per lyerje per te cilat e ka zbritur tvsh-ne ne blerje, nderkohe ka edhe nje ambjent te cilin e leshon me qira si furnizim te perjashtuar.*

Personi i tatueshem nje sasi boje prej bojrave qe tregton e perdor per lyerjen e ambjenteve qe leshon me qira.

***Shembull 2**: Nje shoqeri e cila tregton karburant, per nevoja te mjeteve te ndermarrjes se vet kesaj shoqeri i nevojiten 500 litra karburant gazoil ne nje muaj per ti perdorur per autoveturat e shoqerise qe ka ne dispozicion.*

***Shembull:** Një shoqëri transporti mallrash, një kamion të shoqërisë së saj për të cilin ka zbritur TVSH në blerje e vë në dispozicion të administratorit ose financieres së shoqërisë për transportimin e mallrave personale të shtëpisë.*

C'detyrime i lindin personit te tatueshem per TVSH-ne.

VENDI I FURNIZIMIT TE MALLRAVE

- **Furnizimi i mallrave pa transport - vendi eshte aty ku mallrat behen te disponueshem. (konsumi ne vend ose blerja e mallrave ne piken e shitjes).**
  - Momenti i leshimit te fatures ose dokumentimi I mallit

- **Furnizimi i mallrave me transport: vendi eshte aty ku fillon transporti.**

- **Vendi i furnizimit të energjise/gazit natyror nëpërmjet rrjeteve të shpërndarjes**

  - Kur konsumohet, vendi tek konsumatori

  - Kur rishitet, vendi eshte tek rishitesi

- **Kur mallrat janë furnizuar në bordin e anijeve, avionëve ose trenave, vendi i furnizimit të mallrave është pika e nisjes së transportit të pasagjereve.**

VENDI I FURNIZIMIT TE SHERBIMEVE
NENI 24-30

Parimi i pergjithshem

B2B:
Parimi i vendit te marresit te sherbimit
Neni 24/1

B2C:
Parimi i vendit te furnizuesit
Neni 24/2

- ✓ Perpara verifikohen nenet 25-30, nese sherbimi nuk eshte ne rregullin perjashtimor, i nenshtrohet rregullit te pergjithshem!
- ✓ Personi i tatushem sipas rregullave per vendin e furnizimit

VENDI I FURNIZIMIT TE SHERBIMIT

Ligji 92/2014, date 24.07.2014	Vendi ku është vendosur furnizuesi person i tatueshem	Vendi ku është vendosur marrësi i shërbimit, person i tatueshem	Vendi ku eshte vendosur marresi i sherbimit, person i patatueshem	Vendi i furnizimit te sherbimit/tatimit
Neni 24/1	Ne Shqiperi	Jashte Shqiperise		I patatueshem ne Shqiperi
	Jashte Shqiperise	Ne Shqiperi		I tatueshem ne Shqiperi
Neni 24/2	Ne Shqiperi		Jashte Shqiperise	I tatueshem ne Shqiperi
	Jashte Shqiperise		Ne Shqiperi	I patatueshem ne Shqiperi

VENDI I FURNIZIMIT TE SHERBIMIT PERJASHTIME NGA RREGULLI

- **Sherbimeve te lidhura me pasurine e patundshme (vendi ku eshte pasuria).**
- **Transporti i pasagjereve (proporcionalisht me distancen)**
- **Restoranti, furnizimi me ushqim dhe rasti i furnizimit ne bord te anijeve/avionave/trenave (ku behet nisja)**
- **Dhenja me qera e nje mjeti transporti afat-shkurter B2B(aty ku vihet ne dispozicion mjeti)**
- **Pranimi ne evente (panaire/ekspozita/seminare/kongrese etj B2B) (ku xhvillohet panairi/ eventi)**
- **Transporti i mallrave B2C (proporcionalisht me distancen)**
- **Sherbime te lidhura me evente (panaire/ekspozita/seminare/kongrese etj B2B dhe B2C)**
- **Dhenja me qera e nje mjeti transporti B2C afat-gjate (aty ku banon klienti)**

- **Ndryshe nga sa parashikohet në pikat 1 dhe 2, të nenit 24, të ligjit, pavarësisht nëse**
  - marrësi është person i tatueshëm ose person i patatueshëm,
  - si dhe pavarësisht vendit ku ndodhet marrësi i shërbimit, vendi i furnizimit të shërbimeve për:
    - furnizimin e shërbimeve të lidhura me një pasuri të patundshme,
    - furnizimin e shërbimeve të restorantit dhe shërbimeve të furnizimit me ushqim është në Republikën e Shqipërisë ku këto shërbime janë kryer fizikisht;
    - furnizimin e shërbimeve të restorantit dhe shërbimeve të furnizimit me ushqim, të cilat kryhen në bordin e anijeve, avionëve dhe trenave gjatë transportit të pasagjerëve
    - furnizimin e shërbimit të dhënies me qira afatshkurtër të një mjeti transporti është në Republikën e Shqipërisë nëse ky mjet transporti vihet faktikisht në dispozicion të klientit në Republikën e Shqipërisë.

    Vendi eshte atje ku realizohen faktikisht keto sherbime.

	Vendi ku është vendosur furnizuesi	Vendi ku është vendosur marrësi i patatueshëm i shërbimit	Vendi i tatimit
Nenet 29, 30 te Ligjit 92/2014, date 24.07.2014	Ne Republiken e Shqiperise	Jashte Shqiperise	**I patatueshem ne Shqiperi**
	Jashte Shqiperise	Ne Shqiperi	**I tatueshem ne Shqiperi**

- **Neni 29 “Furnizimi i shërbimeve të telekomunikacionit, të transmetimit dhe shërbimeve elektronike ndaj personave të patatueshëm**

Në përjashtim nga pika 2, e nenit 24, per sherbimet qe iu ofrohen personave te patatueshem, ku vendi eshte ne vendin e furnizuesit te sherbimit, per sherbimet e meposhtme kur iu ofrohen personave te patatueshem vendi eshte ne vendin ku eshte vendosur (banon) personi i patatueshem.

a) **furnizimi i shërbimeve të telekomunikacionit;**

b) **furnizimi i shërbimeve të transmetimit të radios dhe ato televizive;**

c) **furnizimi i website-ve, web-hosting, mirëmbajtjes në distancë të programeve dhe pajisjeve;**

d) **furnizimi me software dhe përditësimi i tyre;**

e) **furnizimi i imazheve, teksteve dhe informacioneve dhe vlefshmëria e bazës të të dhënave (database);**

f) **furnizimi me muzikë, filma dhe lojëra, përfshirë lojërat e fatit dhe bastet, si dhe transmetimet e ngjarjeve politike, kulturore, artistike, sportive, shkencore dhe argëtuese;**

g) **furnizimi i shërbimit të mësimdhënies në distancë;**

Shembull 1.

A nje shoqeri qe tregton programe kompjuterike, blen nje program software nga nje person i tatueshem ne Austri prej 2.000 euro dhe sherbimin e mirembajtjes se software.

Vendi I furnizimit te sherbimit eshte ne shqiperi (marresi I sherbimit B2B) Shoqeria A autongarkon TVSH ne shqiperi dhe regjistron autongarkese ne shitje dhe blerje me TVSH.

Shembull 2

B, person i tatueshem per tvsh-ne në Shqipëri, merr nje sherbim te konsulences juridike ne France prej 5.000 euro. B eshte nje shoqeri qe ofron furnizime sherbimi ne fushen e sigurimeve te perjashtuar nga TVSH, bazuar ne nenin 53 te ligji

Si do te veproje B per TVSH-ne?

- B si person i tatueshëm marrës i shërbimit në Shqipëri do të ngarkojë me TVSH në Shqipëri shërbimin e marrë përsa vendi i furnizimit të shërbimit është në vendin e marrësit. (5000 euro x 135 leke/ euro x 20% = 135.000 leke TVSH
- Nga ana tjetër ky person nuk ka të drejtë të zbresë TVSH- në e këtij shërbimi që i shërben furnizimeve të përjashtuara, të cilat kryen në kuadër të veprimtarisë së tij dhe për pasojë detyrohet të paguajë TVSH-në në Shqipëri prej 135.000 leke

Shembull 3.

Një shoqëri ne Shqiperi vë në dispozicion të një shoqërie me seli në Kosove një ambjent të rregulluar për përdorim zyrash në një ndërtesë te saj ne Shqiperi, kundrejt një shpërblimi, ose nje amjent per te vendosur mobiljet e saj dhe i le ato ne ruajtje.

A tatohet ky sherbim ne Shqiperi?

***Shembull 4**: Një person i tatueshëm në Shqipëri kryen një furnizim shërbimi vlerësim të një pasurie të paluajtshme që është e vendosur në Kosovë. Pasuria e paluajtshme nuk ndodhet ne Shqipëri kështu që vendi i furnizimit të këtij shërbimi nuk është ne Shqipëri.*

Personi i tatueshëm në Shqipëri nuk do të llogarisë TVSH-në në faturën e lëshuar për personin e tatueshëm në Kosovë për shërbimin e vlerësimit të pasurisë së paluajtshme. Ky person që të justifikojë mosllogaritjen e tatimit në çdo rast duhet të provojë dhe dokumentojë që shërbimi është kryer në Kosovë për një pasuri të vendosur atje.

- *Shembull 5. Një person i tatueshëm X i identifikuar për TVSH-në në Shqipëri i kryen një shërbim konsulencë financiare një personi të tatueshëm Z të identifikuar për TVSH-në në Kosovë. Personi i tatueshëm X i lëshon faturë pa llogaritur TVSH p*ersonit të tatueshëm në Kosovë.

- Në faturë duhet të shënohen të dhënat e sakta identifikuese të blerësit të shërbimit, si dhe të përshkruhet qartë lloji i shërbimit. Gjithashtu duhet të shkruhet neni i ligjit ku bazohet mos-tatueshmëria e këtij shërbimi në Shqipëri. *PSh neni 24, pika 1 e ligjit 92/2014, datë 24.07.2014.*

- Këto shitje do të regjistrohen në librin e shitjes dhe deklaratën e TVSH-së në kutinë me emërtimin “shitje pa TVSH”. Personi i tatueshëm furnizues i shërbimit duhet të provojë që shërbimi i ofrohet një personi të tatueshëm të identifikuar për TVSH në jashtë Shqipërisë duke siguruar dokumentacionin e kerkuar.

LINDJA DHE KERKUESHMERIA E TATIMIT

- **Kur lind dhe duhet paguar TVSH ?**

➢ **Per transaksionet brenda vendit:**

- Lindja e tatimit ndodh dhe TVSH-ja bëhet e kërkueshme kur furnizimi i mallrave ose shërbimeve kryhet, përveç kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj.

- **a) "Lindja e tatimit" është ngjarja, nëpërmjet së cilës përmbushen kushtet ligjore të domosdoshme për të kërkuar tatimin mbi vlerën e shtuar;**

- **b) "Kërkueshmëria e tatimit" është e drejta që ka autoriteti tatimor, bazuar në këtë ligj, që duke filluar nga një moment i caktuar t'i kërkojë tatimin mbi vlerën e shtuar personit përgjegjës për pagimin e këtij tatimi edhe nëse momenti i pagesës mund të shtyhet.**

➢ **Ne import lindja e tatimit ndodh dhe TVSH-ja bëhet e kërkueshme ne momentin kur:**

- kryhet importimi i mallrave
- Kur mallrat clirohen nga regjimet doganore

Momenti i furnizimit

MOMENTI I FURNIZMIT

Përcakton :

FURNITORI

Periudhën tatimore në të cilën detyrohet të deklarojë.

TVSH e mbledhshme

KLIENTI

Periudhën tatimore në të cilën ka të drejtën e kreditimit.

TVSH e zbritshme

PARIMI

MALLRAT	Momenti kur mallrat lëvrohen apo bëhen të disponueshme.
SHERBIMET	Momenti kur shërbimet kryhen

VEÇORI

- Momenti i arkëtimit të pagesës kur ndodh më parë se mallrat të lëvrohen apo të bëhen të disponueshme dhe shërbimet të jenë kryer.
- Furnizime të vazhdueshme të kryera rregullisht, në cdo rast për të cilin lëshohet faturë në lidhje me çdo pjesë të atij furnizimi.
- Në ndërtim, fatura lëshohet cdo muaj
- Kur mallrat transferohen në bazë të një kontrate shitjeje me këste, momenti kur paguhet cdo këst.

VLERA E TATUESHME

Vlera e tatueshme e furnizimit te mallrave ose sherbimeve duhet të përfshijë gjithçka që përbën vlerën korresponduese që furnizuesi i mallit ose shërbimit merr ose do të marrë nga blerësi, klienti apo një i tretë, në këmbim të furnizimit, përfshirë edhe subvencionet e lidhura drejtpërdrejt me çmimin e këtyre furnizimeve, përveç TVSH.

- **Vlera e furnizimit ne nje transaksion eshte pikerisht vlera e tregut te transaksionit.**

Me "vlerë tregu" kuptohet:

- **shuma e plotë që blerësi, për të përfituar mallrat apo shërbimet në të njëjtën fazë të tregtimit në të cilën furnizimi kryhet, duhet t'i paguajë në kushtet e konkurrencës së barabartë furnizuesit të mallit ose shërbimit, i cili vepron si i pavarur në kushtet e tregut në Rsh.**
- **Në qoftë se nuk mund të sigurohen vlera të krahasueshme për furnizimet e mallrave ose shërbimeve, atëherë me termin "vlerë tregu" kuptohen shumat e mëposhtme:**
  - a) për mallrat, një shumë jo më e vogël se çmimi i blerjes së mallit apo të mallrave të ngjashme ose, në mungesë të çmimit të blerjes, sa vlera e kostos e përcaktuar në kohën e furnizimit.
  - b) në rastin e shërbimeve, një shumë jo më e vogël se kostoja e plotë e kryerjes së shërbimit prej personit të tatueshëm.

VLERA E TATUESHME- RREGULLA TE VECANTA

- **Rastet qe trajtohen si furnizime kundrejt pageses (neni 9 dhe neni 12).**

1. Në rastet kur PT disponon mallrat që i përkasin pasurisë së sipërmarrjes së tij ose kur cregjistrohet shkronjat (“a”, “b”, “c”,“ç”, pika 2, neni 9),

vlera e tatueshme eshte:

- çmimi i blerjes i këtyre mallrave apo të ngjashme

ose, në mungesë të çmimit të blerjes,

- nga vlera e kostos, e përcaktuar në momentin, në të cilin kryhen veprimet e përdorimit, disponimit apo mbajtjes.

2. Në rastin e furnizimit të shërbimit, (“a”,“b”, pika 2,neni 12) kur mallrat që i përkasin pasurisë së biznesit përdoren për qëllime private ose shërbimet kryhen pa pagesë,

vlera e tatueshme eshte:

- kostoja e plotë e shpenzuar nga personi i tatueshëm për kryerjen e shërbimeve.

VLERA E TATUESHME- RREGULLA TE VECANTA

3. Për rastin e furnizimit të shërbimit (“c”, pika 2, neni 12), të kryera nga personi i tatueshëm për nevojat e biznesit së vet,

vlera e tatueshme eshte:

- vlera e tregut e shërbimit të furnizuar.

4. Nëse furnizimi këmbehet në mallra/shërbime ose pjesërisht në para dhe pjesërisht në mallra/shërbime (natyrë),

vlera e tatueshme e furnizimit duhet të jetë:

- vlera e tregut e mallrave ose shërbimeve të pranuara, e llogaritur në datën, në të cilën tatimi bëhet i kërkueshëm.

Vlera e Tatueshme - Tabele permbledhese

Elemente qe perfshihen ne Vleren e Tatueshme	*Elemente qe nuk perfshihen ne Vleren e Tatueshme*
• TATIMET, TAKSAT, DETYRIMET, TARIFAT DHE PAGESA TË NGJASHME. *Psh: Taksa doganore, tarifa lokale, etj.* • SHTESE MBI CMIM KERKUAR KLIENTIT. *Psh: Rritje cmimi per furnizm te shpejte.* • SHPENZIME QE KRYHEN NGA FURNITORI QE NORMALISHT I NGARKOHEN KLIENTIT. *Psh: Shpenzime siguracioni te mallrave.*	• ULJET DHE REDUKTIMET E ÇMIMIT QË I BËHEN BLERËSIT NË MOMENTIN, NË TË CILIN KRYHET FURNIZIMI APO PËR PAGESA TË HERSHME. • SHUMAT QË KA MARRË NJË PERSON I TATUESHËM SI RIMBURSIM PËR SHPENZIMET E BËRA PËR LLOGARI TË TIJ. • TVSH
Shpenzime Transporti	
• FURNIZUAR(SHITUR) NE ADRESEN E KLIENTIT. Transferimi i pronesise(dorezimi i mallit) behet ne magazinen e klientit. + Shpenzimet e transportit,perfaqesojne nje element te cmimit te shitjes,pra perfshihen ne vleren e tatueshme. .	• FURNIZUAR(SHITUR) NE ADRESEN E SHITESIT Transferimi i pronesise(dorezimi i mallit) behet ne magazinen e shitesit. + Shpenzimet e transportit, perfaqesojne nje Furnizm sherbimi, te vecante(perjashtuar nga vlera e tatueshme e furnizmit te mallit).
Shpenzimet e ambalazheve	
• VLERA E AMBALAZHEVE TË PAKTHYESHME. • VLERA E AMBALAZHEVE TË KTHYESHME QE NUK JANË KTHYER NGA BLERËSI.	• VLERA E AMBALAZHEVE TË KTHYESHME
Subvencionet	
• SUBVENCIONET QË LIDHEN DREJTPËRDREJTË ME ÇMIMIN E NJË FURNIZIMI MALLI OSE SHËRBIMI.	• SUBVENCIONET, QE NUK PËRBËJNË KUNDËRVLERËN E NJË FURNIZIMI SHËRBIMI APO MALLI.

Vlera e tatueshme, zbritjet e cmimit

Bazuar ne nenin 40 te ligjit ne vleren e tatueshme nuk perfshihen ulje ose reduktime te cmimit qe i behen bleresit ose klientit ne kuader dhe per qellime te politikave tregtare te personit te tatueshem qe lidhen me nje furnizim te tilla si:

- **Uljet/zbritjet e cmimit per pagesa te hershme te kryera per furnizimin;**
- **Uljet/reduktimet e cmimit per bleresin ose klientin qe perfitohen ne momentin e furnizimit.**

Psh. Zbritje per cmimin e nje furnizimi per shkak se pagesa behet menjehere ne dore ose se nje pjese e saj eshte paguar me pare.

Nje tjeter shembull mund te ishte skonto tregtare psh klienti perfiton 10 % ulje nese e kryen pagesen e furnizimit brenda 10 diteve.

Zbritjet e cmimit (skontot) duhet te evidentohen ne fature ose kupon per kliente perfundimtar ne momentin e furnizimit dhe reduktojne vleren e furnizimit.

Nese reduktimi i cmimit per furnizimin behet pas momentit te furnizimit atehere saktesohet fatura e leshuar.

- *Shembull 1: Një shoqëri pijesh i jep ekskluzivitetin një shoqërie të tregtojë produktet e markës se saj dhe për këtë i jep një pagese për realizimin e shitjeve të produktit mbi një sasi ose vlerë të caktuar.*

- *Shuma e përfituar nga rishitësi i produkteve është e tatueshme me TVSH, edhe nëse nuk përfitohet si pagesë, por në formën e zbritjes për furnizimin e radhës të kryer.*

- Shembull 2: Një shoqëri përfiton një pagesë bazuar në një klauzolë garancie të vendosur ne kontratë, sipas së cilës i garanton furnizuesit te mallit se mallrat e tij do ti vendosë ose ekspozojë në një vend të dukshëm në supermarket. Pagesa e përfituar në këtë rast nga rishitësi i këtyre mallrave është vlera e shërbimit të kryer për furnizuesin dhe si e tillë është e tatueshme me TVSH 20%.

- *Shembull 3: Një shoqëri përfiton një pagesë bazuar ne një klauzolë garancie të vendosur në kontratë, sipas se cilës përfiton një pagesë shtesë(në formën e një bonusi) nëse tregton brenda një periudhë të caktuar mallrat ose përfundon shërbimin në kushtet e kërkuara dhe sipas cilësisë së percaktuar në kontratë. Pagesa e përfituar në këtë rast nga rishitësi i këtyre mallrave është vlera e shërbimit të kryer për furnizuesin dhe si e tillë është e tatueshme me TVSH 20%.*

- ***(Kujdes nuk kemi te bejme me skonto, por me nje furnizim sherbimi, pra nuk duhet te reduktohet vlera e tatueshme e furnizimit te mallit)***

SHKALLET E TVSH-SE

- **Shkalla e TVSH-së, e aplikueshme për furnizimet e tatueshme, është shkalla e TVSH-së në fuqi në momentin e lindjes së tatimit.**

- **Shkalla e TVSH-së, e aplikueshme për importimet e mallrave, është ajo që aplikohet në territorin e Republikës së Shqipërisë për shitjen e të njëjtit mall.**

- **Shkalla e reduktuar e TVSH nuk kufizon te drejten e zbritjes se TVSH-se. Kjo e drejte ushtrohet e plote ne perputhje me te drejten e zbritjes sipas ligjit.**

- **Ne BE shkallet e reduktuara nuk mund te jene me shume se 2 te tilla;**

- **Shkalla e reduktuar ne BE nuk mund te jete me e vogel se 5%.**

SHKALLET E TVSH-SE

- **Shkalla standarte 20% aplikohet per cdo furnizim pervec atyre te perjashtuara dhe ato per te cilat aplikohet TVSH zero %.**
- **Shkalla e reduktuar 6% aplikohet për:**
  - furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit.
    - Ne sherbimin e akomodimit perfshihet mengjesi kur eshte i perfshire ne cmimin e fjetjes
    - Strukturat akomoduese perfshijne hotel, bar, restorant dhe sherbime te tjera qe ofrohen nga keto struktura ne funksion te veprimtarise akomoduese.
  - **çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese** "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".
    - Ndryshe nga sa me siper per keto te fundit shkalla 6% aplikohet per cdo sherbim qe ofrojne keto struktura (perfshire bar restorant) jo vetem per fjetjen.

VAT
EXEMPTION
Next Exit
universalweather.com/blog

PERJASHTIMET NGA TVSH

- **Ne parim perjashtim nga TVSH do te thote ne te njejten kohe:**

  ➢Perjashtim nga detyrimi per te aplikuar TVSH;

  ➢Perjashtim nga e drejta per te zbritur TVSH-ne e paguar ose TVSH per tu paguar ne blerje, ne importe.

Perjashtimi nga TVSH heq te drejten e zbritjes se TVSH-se.

Perjashtimi nga TVSH duhet te jete i percaktuar, i shprehur ne menyre eksplicite ne ligj;

Cdo furnizim malli ose sherbimi qe nuk eshte i perjashtuar nga TVSH ne menyre te shprehur konsiderohet furnizim i tatueshem sipas ligjit.

- **Kujdes: Perjashtohet nga TVSH furnizimi i mallit ose sherbimit dhe jo personi i tatueshem;**
- **Nje PT mund te kryeje ne te njejten kohe furnizime te perjashtuara dhe te tatueshme ne kuader te veprimtarise se tij.**

- **Perjashtimi nga TVSH jepet per furnizime te kryera, jo per furnizime te marra.**
- **Cdo mall ose sherbim i marre ose perdorur per nje furnizim te perjashtuar nuk gezon te drejten e zbritjes se TVSH-se se paguar ose per tu paguar ne blerje brenda vendit ose import.**
- **Per sherbimet e marra jashte vendit, per te cilat aplikohet reverse- charge, nuk ushtrohet e drejta e zbritjes se tvsh-se, kur i sherbejne furnizimeve te perjashtuara te personit te tatueshem.**
- **Per furnizimet qe merren nga jashte te cilat ne vend jane te perjashtuara nga TVSH nuk aplikohet reverse charge.**

• Perjashtohen nga TVSH:

- **Furnizimi i sherbimit publik postar ne perputhje me sherbimin universal postar; furnizimi i pullave postare per sherbim postar me vleren e parashtypur.**
- **Furnizimi i barnave dhe sherbimeve shendetesore mjeksore dhe paramjeksore,**
  - furnizimi i pajisjeve mjeksore te implantueshme active dhe pajisjeve mjeksore te implantueshme;
  - sherbimet stomatologjike;
    - Kujdes eshte kusht qe te jete **sherbim shendetesor** dhe te furnizohet nga **<u>institucion shendetesor</u>**
- **Furnizimet e sherbimit nga OJF-te per ndihme sociale , te moshuar, femije, te rinj, sport, kulture etj edhe kur jane ne kuader te veprimtarise se tyre ekonomike por me kusht qe te mos sjellin shtremberim te konkurences. (duhet te jene me cmime te reduktuara**
- **Sherbimet arsimore te te gjitha niveleve, kurset e licensuara nga institucioni perkates qe jene perplotesimin e programeve mesimore;**
  - nuk perfshihen trajnime ne fusha te ndryshme profesionale ose kurse profesionale

PERJASHTIMET

Bazuar ne piken c) te nenit 51 te ligjit perjashtohet nga TVSH-ja:

- furnizimi i shërbimeve shëndetësore ndaj pacientit ku perfshihen të gjitha shërbimet per parandalimin, diagnozën, trajtimin, kurimin e sëmundjes apo çrregullimeve shëndetësore dhe rehabilitimin.

Ne kuptim te kesaj dispozite "veprimet e lidhura me sherbimet shendetesore" jane veprimet e domosdoshme qe furnizohen (kryhen) nga vete insitucioni shendetesor, si pjese dhe per ofrimin e sherbimit shendetesor.

Shembull: Nje shoqeri, person i tatueshem ofron sherbimin e pergatitjes dhe shperndarjes se ushqimit per pacientet e nje spitali.

Kemi disa situata:

1. Sherbimi i ofrohet nga shoqeria drejtperdrejt per pacientet e spitalit. (i tatueshem)

2. Sherbimi i ushqimit i ofrohet (furnizohet) spitalit nga shoqeria ne fjale. (I tatueshem)

3. Spitali ia ofron vete vaktet pacientit. (I perjashtuar)

4. Spitali u ofron ushqimin jo vetem pacienteve, por edhe mjekeve edhe te tjereve te aferm te pacienteve. (I tatueshem)

- **Sherbimet e sigurimit, risigurimit, sherbimi i agjenteve dhe brokerave te sigurimit .**

- **Sherbimet financiare si kredidhenia nga kredidhenesi; llogarite e depozitave; veprimet e kembimit; transaksionet per valuten, kartmonedhat; transaksionet perfshire negocimin ne aksione.**

- **Nuk perjashtohen sherbimet financiare:**
  - Sherbimi i mbledhjes se borxhit;
  - Transaksionet lidhur me monedhat dhe kartmonedhat per koleksion; monedha ari, argjendi, apo te tjera qe nuk perdoren si mjet ligjor pagese ose qe paraqesin interes numizmatik.
  - Transaksionet per menaxhimin dhe ruajtjen ne aksione kuota, pjese ne shoqeri.
  - Dhenia me qira e kasafortave;

***Shembull**: Nje klient paraqitet prane nje banke per te marre nje kredi. Dhenia dhe negocimi i kredise edhe menaxhimi i saj jane operacione te perjashtuara nga tvsh-ja.*

Klienti paraqet nje dosje jo shume te mire dhe banka refuzon kredine ose i jep nje kredi jo te favorshme. Nje person i tatueshem i cili kryen veprimtari si negociues, merr persiper te kryej kete sherbim per klientin prane bankes. Ky person mund te jete individ ose agjensi.

- *Sherbimi i kryer nga negociuesi per klientin?*
- *Sherbimi i kryer nga negociuesi per banken ?*

***Shembull.** Nje banke jep te drejten e perdorimit te bankomatit nje banke tjeter.?*

***Shembull**: Nje kompani internet e vednosur ne Itali i ofron internetin bankes ?*

- Furnizimi i tokes, nderteses;

- dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, përveç:
  - dhënies me qira të ndërtesave për një periudhë deri në dy muaj;
  - strehimit në hotele ose vende pushimi, të kryera në sektorin e hotelerisë ose në sektorë që kanë funksione të njëjta, përfshirë qiradhënien e kampeve të pushimit apo të terreneve të pajisura për kampingje;
  - dhënien me qira të zonave të destinuara për parkimin dhe magazinimin e automjeteve dhe mjeteve të tjera lëvizëse;
  - dhënien me qira të pajisjeve dhe makinerive të fiksuara në mënyrë të qëndrueshme;
  - dhënien me qira të kasafortave;

- Kujdes me opsion trajtohet si furnizim i tatueshem me TVSH!

  -Furnizimi i ndertesave (jo per banim);

  -Qiradhenia e ndertesave (jo per banim);

- Furnizimi i kartave te identitetit
- Lojrat e fatit, pervec komisionit te sherbimit te ndermjetesve per lojrat e fatit.
  - *Shembull: Nje shoqeri bastesh me kuaj i jep me qira 10 kuaj per organizimin e nje shfaqje sportive nje klubi sportive?*
- Furnizimi i shërbimeve të shtypshkronjave për gazetat, Furnizimi i gazetave, librave, revistave, reklamat nga media e shkruar dhe elektronike.

  -Reklamat e furnizuara nga cdo agjensi apo subjekt jo media jane te tatueshme.

  -Shembull: Të ardhurat që media përfiton nga furnizimi i një programi për një televizion tjetër, ose shitja e një kronike televizive, ose shitja ose vënia nëdispozicion e kohës televizive për transmetim, etj, nuk janë furnizime shërbimi të përjashtuar nga TVSH.
- furnizimi i shërbimeve <u>të destinuara vetëm për realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure,</u> të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët, të vërtetuar si të tillë nga AKBN, lidhur me realizimin e fazës së kërkimit, si dhe furnizimi i mallrave që bëjnë kontraktorët për njëri-tjetrin ose nënkontraktorët për kontraktorët e tyre, të importuara sipas pikës 39, të nenit 56, të këtij ligji.

PERJASHTIMET NE IMPORT

- **Ne import jane te perjashtuara ato qe jane te perjashtuara edhe ne vend**
- **Jane gjithashtu te perjashtuara , duke perfshire nje sere perjashtimesh per mallra qe nuk jane per qellime tregtare por jane kryesisht dergesa ose per qellime te percaktuara si per dhurata per delegacione, eksperimente, kerkime etj;**

- **makinerite dhe pajisjet per investime mbi 50 milion leke ,**
- **importimi I mallrave per kerkimet hidrokarbure,**
- **pajisje dhe makineri per perpunimin aktiv dhe agrobiznesin dhe**
- **makinat bujqesore si dhe importimi I makinerive prodhuese nga biznesi I vogel,**
- **kafshet e gjalla per majmeri.**

Neni 54 – Perjashtohen nga TVSH:

- **Për të siguruar një taksim të drejtë të TVSH-së, ndryshe nga sa ka qene aplikuar me ligjin e vjeter, përjashtohen nga TVSH në shitje mallrat që:**

  - janë përdorur për një veprimtari të përjashtuar dhe për këtë qëllim nuk e kanë zbritur TVSH-në që kanë paguar më parë.

  - ato mallra për të cilat tvsh nuk është e lejuar të zbritet për shkak të kufizimeve ligjore (neni 74).

- *1. Banka blen software me 01.05.2015. E perdor software dhe ne 31.12.2016 e zevendeson me nje software tjeter. Si do te veproje per TVSH-ne?*
- *2. Nje kompani blen nje autoveture me 30.10.2014 . Autoveturen e shet me 30.09.2015 . Si do te veproje per TVSH-ne?*

FURNIZIMET ME SHKALLE ZERO/ EKSPORTET

- Furnizimi i mallrave të dërguara ose të transportuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shitësi ose për llogari të tij;
- furnizimi i mallrave të dërguara ose të transportuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga/ose për llogari të një blerësi që nuk është i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë;
  - Ky parashikim nuk zbatohet për mallrat e transportuara nga vetë blerësi për t'u përdorur për pajisjen apo furnizimin e anijeve turistike, mjeteve fluturuese private apo të çdo lloj mjeti tjetër transporti të përdorur për përdorim privat;
- furnizimi i shërbimeve, përfshirë transportin dhe operacionet ndihmëse, përveç shërbimeve që janë të përjashtuara në përputhje me nenet 51 dhe 53, të këtij ligji, <u>në qoftë se janë të lidhura drejtpërdrejt me eksportimet apo importimet e mallrave, sipas nenit 22, të këtij ligji.</u>
- Transporti nderkombetar i pasagjereve, furnizimi, riparimi, qiradhenia e mjeteve ajrore dhe detare per transport nderkombetar te pasagjereve.

- **Trajtohen si furnizime të ngjashme me eksportet:**

- a)furnizimet e mallrave dhe shërbimet e kryera në kuadrin e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore;

- b)furnizimet e mallrave dhe shërbimeve ndaj organizatave ndërkombëtare, si dhe anëtarëve të këtyre organizatave, të njohura si të tilla nga ana e autoriteteve publike të RSH.

- c) Furnizimet e mallrave dhe shërbimeve në RSH, të destinuara për forcat e armatosura të shteteve të tjera anëtare të NATO-s për t'u përdorur nga këto forca apo personeli civil që i shoqëron ato.

E DREJTA E ZBRITJES SE TVSH

- **Parim :**

E drejta e zbritjes lind kur TVSH-ja e zbritshme bëhet e kërkueshme.

Neni 32 përcakton lindjen dhe kërkueshmërinë e tvsh-së prej furnizuesit. Në këtë kuptim, atëherë kur tvsh bëhet e kerkueshme per furnizuesin dhe ai duhet ta paguaje ate, ne te njëjtin moment lind e drejta e zbritjes së kësaj tvsh-je, për personin që ushtron të drejten e zbritjes.

- **Personi i tatueshëm gëzon të drejtën që të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur për transaksionet e tatueshme**
  - TVSH-në e paguar apo për t'u paguar në Republikën e Shqipërisë për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve që i janë furnizuar ose do t'i furnizohen këtij nga ana e një tjetër personi të tatueshëm;
  - TVSH-në e paguar për mallrat e importuara në Shqipëri.

E DREJTA E ZBRITJES USHTROHET GJITHASHTU:

- furnizimet në kuadër të veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm, të kryera jashtë territorit të RSh, të cilat në qoftë se do të kryheshin brenda vendit do t'i jepnin të drejtën e zbritjes së TVSH-së personit të tatueshëm.

- furnizimet e personit të tatueshëm me shkallë zero të TVSH-se.

- furnizimet e personit të tatueshëm, të përjashtuara nga TVSH-ja, në përputhje me nenin 53, shkronjat nga "a" deri në "dh", kur personi i tatueshëm, të cilit i destinohen shërbimet është i vendosur jashtë Republikës së Shqipërisë ose kur transaksione të tilla janë drejtpërdrejt të lidhura me mallra të destinuara për t'u eksportuar jashtë Republikës së Shqipërisë.


PERMBAJTJA
Mallrat e blera dhe shërbimet e përftuara duhet :
Të përdoren për qëllime të operacioneve të tatueshme.
Të jenë të domosdoshme e në përputhje me veprimtarinë ekonomike.
Nuk janë të përjashtuara nga e drejta e kreditimit, nga ndonjë tekst nënligjor i vecantë.
FORMA
Faturë tatimore origjinale
Deklaratë doganore importi
KOHA
Periudhën kur TVSH bëhet e kërkueshme tek furnizuesi
V.O. Jo më vonë se 12 muaj nga data e faturës apo deklaratës doganore të mportit

SKEMA E PERGJITHSHME E ZBRITJES SE TVSH



ZBRITSHMERIA E TVSH

- **Rregullimi i zbritjes se tvsh-se kur mallrat perdoren si per furnizime te perjashtuara dhe per furnizime te tatueshme dhe ndryshojne perdorimin pergjate periudhes se rrgullimit do te behet:**
  - per mallrat e luajtshme deri ne 5 vjet (kur ndyshon perdorimi ne nje veprimtari pa te drejte te zbritjes se TVSH-se) dhe
  - per mallrat e paluajtshme deri ne 10 vjet.

- **<u>Nuk kufizohet e drejta e zbritjes per:</u>**
  - <u>Furnizime te tatueshme (Shkalle standarte ose e reduktuar);</u>
  - <u>Eksporte ose furnizime me shkalle zero</u>
  - <u>Furnizime te kryera jashte (vendi i furnizimit) te cilat nese do te kryheshin ne vend nuk do te ishin te perjashtuara.</u>

KUFIZIME TE SE DREJTES SE ZBRITJES SE TVSH

a) shpenzimet e karburantit, përveç rastit kur:

i) qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e karburantit me qëllim për ta shitur atë;

ii)karburanti i blerë është përdorur për nevoja teknologjike në funksion të arritjes së qëllimit primar të biznesit.

Në këtë rast, TVSH-ja kreditohet deri në normativat e përcaktuara në udhëzimin e MF sipas veprimtarive;

b) shpenzimet e karburantit të çdo lloji, i përdorur për autoveturat;

c) shpenzimet për autovetura dhe shërbimet në lidhje me to, përveç rasteve kur:

i) qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e autoveturave vetëm me qëllim për t'I shitur ato;

ii)përdorimi i autoveturave është i vetmi qëllim i veprimtarisë ekonomike (dhënia me qira, shërbimi i taksive, ambulancave dhe veprimtari të ngjashme të kësaj natyre);

ç) **shpenzimet për udhëtime e dieta, strehimin në hotele, veprimtari çlodhëse dhe argëtuese, shpenzime luksi dhe të përfaqësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike**.

Për shpenzimet e përfaqësimit e drejta e zbritjes nuk lejohet për shpenzime përtej normës së lejuar për njohjen e tyre si shpenzim i zbritshëm, në përputhje me ligjin që trajton tatimin mbi fitimin.

- **Normativat aplikohen mbi bazën e treguesit të përcaktuar sipas peshës specifike, që blerjet për gazoil zënë në raport me qarkullimin e tatueshëm, të kryer në kuadër të veprimtarisë ekonomike.**
- I. **NDËRTIM**
  - a) Prodhim materiale inerte deri më 33%
  - b) Ndërtim shtrim rrugësh deri më 32%
  - c) Ndërtim banesash dhe objektesh të ndryshme deri më 8%
  - ç) Prodhim betoni deri më 14%
  - d) Gërmime / shpime deri më 25%
  - dh) prodhim tullash dhe tjegullash deri me 33%
- II**. TRANSPORT**
  - a)Transport udhëtarësh deri më 43 %
  - b)Transport mallrash deri më 38 %
  - c) Transport mallrash me mjete teknologjike deri me 78 %
- III**. SHËRBIME**
  - a) Autoshkolla deri më
  - b) Shërbime pastrimi qyteti deri më 30%
  - c) Peshkimi deri më 80%

RREGULLA PRAKTIKE TE ZBATIMIT TE ZBRITJES (KOEFICENTET)

Ne funksion te perdorimit te mallit/ sherbimit percaktohen :

- *koeficenti i tatueshmërisë* : proporcioni i perdorimit te mallit apo sherbimit per nje veprimtari per te cilen personi konderohet si person i tatueshem ne kuptim te nenit 3 te ligjit, dhe perdorimit te mallit/sherbimit nga i njejti person per qellime qe nuk kane te bejne me veprimtarine e tij ekonomike, sipas pikave 2 dhe 3 te nenit 69 te ligjit.

- *koeficienti i zbritjes se pjesshme te TVSH-se*: pjesa e perdorimit te mallit apo sherbimit per furnizime ne fushen e zbatimit te TVSH-se, per furnizime qe japin te drejten e zbritjes, sipas nenit 71 te ligjit

- koeficenti i kufizimit: furnizimi i mallit apo sherbimit eshte shpehimisht objekt i kufizimeve te nenit 74 te ligjit;

Skema finale : E drejta e zbritjes së TVSH



SHEMBUJ:
LLOGARITJA E KOEFICENTIT (FINAL)TE ZBRITJES SE TVSH

- TVSH e zbritshme eshte e barabarte : TVSH ne fature x Koeficienti i zbritshmerise.

Person i tatueshem ; aktivitet tregti mallra industriale.

1- Blerje kepuce.

A-	Koeficienti i tatueshmerise	1	KOEFICIENTI ZBRITSHMERISE	1
B-	Koeficienti i zbritjes	1		
C-	Koeficienti i kufizimit	1	A x B x C	

2- Fature ushqimi,udhetimi personale

A-	Koeficienti i tatueshmerise	0	KOEFICIENTI ZBRITSHMERISE	0
B-	Koeficienti i zbritjes	1		
C-	Koeficienti i kufizimit	1	A x B x C	

SHEMBUJ:
LLOGARITJA E KOEFICENTIT (FINAL)TE ZBRITJES SE TVSH

1- Fature cigare. (qellime ekonomike e jo te tatueshme)

A-	Koeficienti i tatueshmerise	1	KOEFICIENTI ZBRITSHMERISE	0
B-	Koeficienti i zbritjes	0		
C-	Koeficienti i kufizimit	1	A x B x C	

2-Blerje benzine per autoveturen e aktivitetit (qellime ekonomike, tatueshme, e kufizuar)

A-	Koeficienti i tatueshmerise	1	KOEFICIENTI ZBRITSHMERISE	0
B-	Koeficienti i zbritjes	1		
C-	Koeficienti i kufizimit	0	A x B x C	

SHEMBULL 2

- Personi i tatueshem ka xhiro nga aktiviteti i tatueshem 5 milione leke si avokat dhe 2 milione xhiro e aktivitetit te perjashtuar (qira) pa te drejte zbritjeje te TVSH.
- Ndertesen ku ushtron aktivitetin, e perdor 70%, per nevoja te tij dhe 30%, per banim.
- Transaksione.
  - Shpenzime mirembajtje, TVSH 100 000 leke
  - Fature gazoili perdor per autoveture, TVSH 50 000 leke.
- Llogaritur koeficientet:
  - Koeficienti i tatueshmerise 0.7
  - Koeficienti i zbritjes se TVSH:

    5 000 000 / 5 000 000 + 2 000 000 = 72%.
  - Koeficienti i kufizimit per gazoilin, 0

TABELA PERMBLEDHESE.

	Koeficienti tatueshmerise	Koeficienti i zbritjes	Koeficienti i kufizimit	TVSH e zbritshme
TVSH-mirembajtje = 100 000	0,7	0,72	1	50,400
TVSH gazoil = 50 000	1	0,72	0	0
Totali TVSH 150 000				50.400

REGJIMI PËR AGJENCITË E UDHËTIMIT

- Veprimet që agjencia e udhëtimit kryen në emrin e saj, në përfitim të klientit per te cilat perdor furnizime te mallrave dhe të shërbimeve të furnizuara nga persona të tjerë të tatueshëm, ne kuptim te pikes 1 te nenit 124 te Ligjit per TVSH- ne, konsiderohen si furnizim i nje sherbimi te vetem teresor.

- Vetëm veprimet e kryera nga agjencitë e udhëtimit apo organizatoret turistik që veprojnë në emër të tyre, pra sillen si ndërmjetës të fshehur mund të aplikojnë këtë regjim.

MARZHI AGJENCISE SE UDHETIMIT

Vlera e Tatueshme e shërbimit të vetëm të agjencisë së udhetimit (AU)

Si rregull, marzhi i agjentit të udhëtimit përfshin edhe TVSH-në dhe llogaritja e vlerës së tatueshme dhe të TVSH-së së mbledhshme sipas këtij regjimi bëhet si më poshtë:

a) Vlera e tatueshme = Marzhi i AU - TVSH-në e mbledhshme

b) TVSH e mbledhshme =Vlera e tatueshme (x) shkalla tatimore e TVSH-së (20%)

MARZHI AGJENCISE SE UDHETIMIT

Shembull 1: Agjencia ofron nje udhetim turistik neper jugun e Shqiperise i cili zgjat 2 nete dhe cmimi i percaktuar për çdo udhëtar është 15.000 lekë

Faturat e pranuara nga agjencia jane:

	Vlera pa TVSH	TVSH	Vlere me TVSH
Shërbim fjetje hoteli 2 netë/person	3000	600	3600 leke
Sherbim transporti vajtje ardhje/person	1000	200	1200 leke
Sherbim katering /person	2000	400	2400 leke
Totali			7200 lekë

Cmimi i paguar nga udhetari	15000 Lek
(-)totali i shpenzimeve/person	7200 Lek
=Marzhi i agjencise	7800 Lek

TVSH e mbledhshme = 7800*20/120= 1300 Lek

Në kutine përkatëse të librit të shitjes ne vleren e tatueshme shenohet 6500 leke; TVSH 1300 leke te cilat deklarohen edhe ne DTVSH.

MARZHI AGJENCISE SE UDHETIMIT

Shembull 3: Agjencia ofron një udhëtim turistik me itenerar Tiranë-Korçë - Selanik- Tirane i cili zgjat 2 netë dhe çmimi i përcaktuar për çdo udhëtar është 25.000 lekë.

	Selanik	Korçë	vlera me TVSH Totali
Shërbim fjetje+ushqim/person	*4000 Lek*	*8000 Lek*	*12000 Lek*
Shërbim transporti /person	*1500 Lek*	*5000 Lek*	*6500 Lek*
Totali	*5500 Lek*	*13000 Lek*	*18500 Lek*
Pesha specifike	*29.7%*	*70.3%*	

*Pjesa e çmimit qe i takon udhetimit brenda vendit (25000*29.7%)* *7425 Lek*

(-)totali i shpenzimeve/person brenda vendit *5500 Lek*

=Marzhi i agjencise *1925 Lek*

TVSH e mbledhshme = *1925*20/120=* *321 Lek*

Ne kutine perkatese te librit te shitjes ne vleren e tatueshme shenohet 1604 leke; TVSH 321leke dhe Marzhi total 1925 leke

Në faturën e shitjes qe agjencia i bën klientit shenon vetëm vlerën totale të paguar prej 25.000 lek dhe nuk llogarit TVSH.

	Shteti EU	Standart rate	Reduced rate	Vat registration threshold (Euro)
1	Austria	20%	13%,10%	30.000
2	Belgjika	21%	12%,6%	25.000
3	Bullgaria	20%	9%	25.565
4	Kroacia	25%	13%, 5%	30.864
5	Qipro	19%	9%,5%	15.600
6	Cekia	21%	15%,10%	37.008
7	Danimarka	25%	-	6.726
8	Estonia	20%	9%	40.000
9	Finlanda	24%	14%, 10%	10.000
10	Franca	20%	10%, 5.5%, 2.1%	82.800 goods 33.200 services
11	Gjermania	19%	7%	17.500
12	Greqia	24%	13%,6%	-
13	Hungaria	27%	18%,5%	-
14	Irlanda	23%	13.5%,9%,4.8%	75.000 goods 37.500 services
15	Italia	22%	10%,5%,4%	60.000
16	Letonia	21%	12%,5%	40.000
17	Lituania	21%	9%, 5%	45.000
18	Luksemburgu	17%	14%, 8%, 3%	30.000
19	Malta	18%	7%, 5%	-
20	Hollanda	21%	6%	1.345
21	Polonia	23%	5%,8%	46.442
22	Portugalia	23%	13%,6%	12.500
23	Rumania	19%	9%,5%	48.725
24	Sllovakia	20%	10%	49.790
25	Sllovenia	22%	9.5%	50.000
26	Spanja	21%	10%,4%	-
27	Suedia	25%	12%, 6%	-
28	UK	20%	5%	85.000 pound (98.000 euro)

FALEMINDERIT !